



Prishtinë, 15.08.2008  
Kodi i ZRRE-së: D\_110\_2008

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:**

1. Nenin 15,26 dhe Kreut 7 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenin 3 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe
3. Aplikacionit për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të datës 10.04.2008 të ndërmarrjes KazTransGas AG me adresë Via Cattori 7, 6920 Paradiso, Lugano, Zvicër, me Degë në Prishtinë, Sylejman Vokshi Hy 3/4, , **në seancën e mbajtur me date 15 gusht 2008, nxori këtë:**

**VENDIM**

**I. I LËSHOHET** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike ndërmarrjes KazTransGaz AG.

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) me datë 10.04.2008 ka pranuar nga përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë KazTransGaz AG aplikacionin për licencë Furnizim/Tregti me energji elektrike.
2. ZRRE me datë 22.04.2008 ka bërë vlerësimin në detaje të çdo dëshmie të dërguar dhe ka vlerësuar se aplikacioni dhe dëshmitë e dëguara janë në përputhje me kërkesat që dalin nga Rregulli për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë dhe legjislacionin e aplikueshëm për energjinë në Kosovë.
3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
4. Palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose nga data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordit i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE:

\_\_\_\_\_  
Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, anëtar